



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

UDHËZUES

PËR

SHKRIMIN

E

OPINIONEVE LIGJORE

I. OPINIONET LIGJORE

Struktura “PLAK”

“PLAK” është një strukturë e përgjithshme analitike që nuk ka vlera ligjore. Vlerat e kësaj strukture janë thjesht praktike dhe kanë të bëjnë me të shpjeguarit dhe të arsyetuarit logjik të një përfundimi. Me pak fjalë, është një mënyrë e thjeshtë dhe praktike e organizimit të një opinionit ligjor.

Struktura “PLAK” ka katër pjesë kryesore:

- 1) Problemi,
- 2) Ligji,
- 3) Analiza dhe
- 4) Konkluzioni.

Secila pjesë analizohet në mënyrë të kujdesshme, në mënyrë që t’i tregohet lexuesit secili hap në procesin e arsyetimit që të çon në parashikimin ose përfundimin e arritur.

1. Problemi (identifikimi i problemit ligjor që duhet zgjidhur)

Pjesa e parë e strukturës “PLAK” paraqet problemin ose çështjen rreth së cilës diskutohet.

Paraqitja e problemit bëhet edhe në formën e një përfundimi.

1.1. Paraqitja e problemit

Paraqitja e problemit tërheq vëmendjen e lexuesit për faktet ligjore përcaktuese që janë të rëndësishëm për çështjen në diskutim. Faktet përcaktuese janë ato fakte mbi të cilat bazohet analiza. Paraqitja e problemit bëhet në mënyrën si vijon:

Opinionit vijues ka të bëjë me faktin nëse Genti ishte njoftuar për problemin edhe pse Agimi nuk foli drejtpërdrejt me Gentin, por i la një mesazh në sekretarinë telefonike e cila nuk funksiononte.

Ky shembull tregon se çështja e “njoftimit” po shqyrtohet me kujdes.

1.2. Paraqitja e problemit në formën e një përfundimi

Në vend që thjesht të bëhet identifikimi dhe paraqitja e pikave për diskutim, fjalia kryesore hartohet në formën e një përfundimi për çështjen. Shembulli në vijim paraqet problemin që është analizuar në formën e një përfundimi:

Genti nuk kishte as informacion të drejtpërdrejtë e as të tërthortë për problemin e Agimit, pasi Agimi nuk foli kurrë me Gentin apo me ndonjë agjent të tij, por ai thjesht la një mesazh në sekretarinë telefonike të Gentit.

Në formën e përfundimit, fjalia kryesore përsëri i bën me dije lexuesit çështjen në diskutim, por njëkohësisht tërheq vëmendjen tek faktet që janë me rëndësi për përcaktimin e çështjes.

2. Ligji (citimi i ligjit dhe shpjegimi i ligjit)

Pjesa e dytë e analizës “PLAK” është diskutimi për ligjin i cili përcakton dhe rregullon problemin në fjalë. Një diskutim i plotë i ligjit kërkon, si citimin e ligjit për çështjen në diskutim, ashtu edhe një shpjegim të detajuar të ligjit në mënyrën si është zbatuar më parë në raste të ngjashme ose përgjithësisht të ngjashme.

Me citimin e ligjit, lexuesit i paraqitet konteksti i pjesës tjetër të analizës. Citimi i ligjit bëhet për të arritur në një përfundim sa më të qëndrueshëm dhe objektiv.¹ Në shumë raste, duhet përmbledhur një rregullim ligjor prej dy ose më shumë çështjeve ligjore. Shpesh, ligjet nuk citohen në mënyrë të qartë në asnjë prej rasteve të rëndësishme. Për shembull:

Lidhjet e rëndësishme me një juridiksion, përfshijnë vazhdimin e interesave personale dhe afariste, ushtrimin e të drejtës për të votuar, dhe vazhdimin e banimit të anëtarëve të familjes aty. [citim]

Kur një i burgosur ka lidhje familjare, afariste dhe shoqërore të vendbanimit të tij fillestar, dhe pak ose aspak lidhje të tilla me shtetin ku është burgosur, gjykatat prirën të konstatojnë se të burgosurit i mungon ndryshuar vendbanim. [citim]

Kur trajtohet një problem i rregulluar nga një akt normativ, citimi ligjor aktit. Atë e pason shpjegimi se si e kanë interpretuar gjykatat atë dispozitë ligjore.

Shpjegimi i ligjit

Shpjegimi i ligjit kërkon përdorimin e rasteve për të shpjeguar ose ilustruar citimin ligjor. Çështjet duhen shpjeguar me saktësi dhe me hollësi të mjaftueshme, në mënyrë që lexuesi të dijë se përse përdoren pikërisht këto raste dhe pse ato janë me rëndësi për përfundimet e arritura.

Përdorimi i “rasteve më të mira” varet nga faktorë të ndryshëm. Në precedenti prej gjykatës më të lartë, nëse ka një precedent të tillë. Përdoret precedenti që gjykatat mendojnë se është më i rëndësishmi për çështjen, pra, “rasti kryesor” (ose rastet).

Përdoren rastet e kohëve të fundit dhe zgjidhen rastet që kanë fakte më të ngjashme me ato të rastit në diskutim dhe arsyetim të zbatueshëm për rastin.

Shih: Neni 12 (Paragrafi 6), Ligji nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / nr. 74 / 20 korrik 2010: Të gjithë shfrytëzuesit e materialeve të Gazetës Zyrtare duhet të cekin emrin, numrin dhe vitin e botimit të Gazetës Zyrtare. (Citim)

Kjo ndarje, megjithatë, nuk kthehet në një ekspozitë me “përmbledhje të shkurtra rastesh”.

Pra, duhet të merret prej secilit rast vetëm ajo që është e nevojshme përfundimet: faktet, baza ligjore dhe arsyetimet, pasi ato lidhen me çështjen që diskutuar.

3. Analiza (zbatimi i ligjit bazuar në faktet e rastit)

Deri në këtë ndarje, është identifikuar dhe paraqitur problemi që po diskutohet dhe duhet të jetë cituar dhe shpjeguar ligji i zbatueshëm për rastin në shqyrtim. Është momenti që të shpjegohet se si zbatohet kuadri ligjor ndaj fakteve të rastit.

3.1. Analogjia dhe dallimet

Gjatë shpjegimit se si zbatohet ligji duke pasur parasysh faktet e rastit, është e nevojshme që të përdoret analogjia dhe dallimet. Ndërsa zbatohet ligji bazuar në faktet thelbësore të rastit, këto fakte krahasohen me faktet thelbësore të rasteve të rëndësishme të precedentëve. Ky është procesi i analogjisë, i cili nxjerr në pah ngjashmëritë dhe dallimet e rëndësishme midis rastit në diskutim dhe rasteve precedentë që janë përfshirë në shpjegimin e ligjit.

Për të trajtuar dallimin ndërmjet rasteve, një analizë e saktë shpjegon rëndësinë ligjore të fakteve të rastit nën dritën e rregullimit ligjor. Përdoret citimi i ligjit për faktet e rastit, shpjegohet nëse ligji është ose jo i përshtatshëm në situatën konkrete përmes referencave specifike të fakteve të rastit tuaj dhe rasteve precedentë që kanë rëndësi të veçantë. Me pak fjalë, një analizë e fortë përfshin zbatimin e ligjit në fuqi për faktet e rastit tuaj dhe, nëse është e domosdoshme, i referohet fakteve të rasteve precedentë për të treguar se si ngjajnë dhe/ose dallojnë faktet e rastit tuaj nga faktet e këtyre rasteve, duke kërkuar të njëjtin rezultat ligjor (ose të ndryshëm).

Përveç analogjisë së precedentit bazuar në fakte dhe arsyetime, merren në konsideratë edhe interesat e politikave publike, nëse ka të tilla, të cilat janë marrë në konsideratë nga gjykatat si bazë për vendimet e tyre. Nëse gjykatat gjatë vendimmarrjes së rasteve precedentë janë udhëhequr nga elementët e politikave publike, përcaktohet nëse të njëjtat çështje të politikave shin mundësi të ngjallnin interesimin e gjykatës në rastin tuaj.

3.2. Kundër-analiza

Faktet, arsyetimet, politika publike: të gjitha këto përdoren për të bërë krahasime me precedentët e mëparshëm. Megjithatë, derisa të jetë trajtuar çdo kundër-argument i sugjeruar me ligj, ndarja juaj që analizon ligjin kundrejt fakteve në fjalë nuk konsiderohet e kompletuar. Një kundër-argument mbështet një përfundim të kundërt me atë që keni arritur.

Për të trajtuar dhe hedhur poshtë një kundër-argument, së pari, duhet të mendoni për anën e kundërt të përfundimit tuaj në lidhje me çështjen që po shqyrtoni. Pyesni veten nëse është e mundur që përfundimi juaj të jetë i gabuar. Identifikoni dhe shqyrtoni argumentin ose argumentet më të mira që mund të shpien në një përfundim të ndryshëm, përfshirë të gjithë precedentët që mbështesin këtë përfundim të ndryshëm. Më pas, tregoni

se pse keni mbërritur në përfundimin se këto argumente alternative nuk janë aq të forta sa ato që shpien në përfundimin tuaj.

Së fundi, mos e lejoni faktin që ju përfaqësoni njërin prej palëve kundërshtare të mjegullojë gjykimin tuaj të arsyeshem. Tregohuni objektivë. Mos lini pa përmendur raste që janë të dëmshme për rastin tuaj. Ju nuk do t'i ndihmoni askujt duke i shfaqur një pamje jo realiste në lidhje me rezultatin e mundshëm.

Pas përfundimit të fazave të mësipërme të analizës, pason përfundimi në lidhje me çështjen.

Kjo i jep lexuesit mundësinë që të bëjë një përmbledhje të parashikimit lidhur me çështjen.

Përfundimi jepet vetëm për problemin në fjalë dhe jo në një këndvështrim të gjerë të tij (ku problemi në fjalë është vetëm një pjesë e problemit në këndvështrimin e gjerë të tij).

4. Konkluzioni

Pas përfundimit të fazave të mësipërme të analizës, pason përfundimi në lidhje me çështjen.

Kjo i jep lexuesit mundësinë që të bëjë një përmbledhje të parashikimit lidhur me çështjen.

Përfundimi jepet vetëm për problemin në fjalë dhe jo në një këndvështrim të gjerë të tij (ku problemi në fjalë është vetëm një pjesë e problemit në këndvështrimin e gjerë të tij).